

## FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 30 QERSHOR 2022

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

E nderuar Kryetare e seancës,

Të nderuara zonja ministre, duke ju ndjekur me shumë vëmendje dhe me shumë respekt në fjalët tuaja gjatë seancës së sotme, por edhe në seancat e shkuara, mendoj se karakterizimi si qeveria e mirëqenies së shifrave dhe mjerimit të qytetarëve është më i përshtatshmi që mund t'ju shkojë. Ju dëgjoj me një agoni kur i bëni apologji një kritike që nuk ju bëhet. E theksoj për të disatën herë në diskutimet e mia në seancat plenare: nuk ju akuzon askush, as ministren e Financave, as të Shëndetësisë, as zotin Majko, as Kryeministrin tuaj se jeni ju shkaktarët e shkëputjes së zinxhirit të furnizimit, të rritjes së çmimeve dhe të krizës në përgjithësi. Jo, nuk jeni ju, është pandemia, është edhe evazioni rus në Ukrainë.

Ju përpiqeni t'i bëni apologji asaj që nuk ju akuzojnë me qëllim që t'i shmangeni përgjegjësisë që ju rëndon kryekëput juve. Ku është kjo përgjegjësi? Në politikat që ju po ndiqni në trajtimin e krizës dhe të pasojave të saj. Kriza, si çdo fenomen tjetër politik ka dy anë dhe në rastin tonë ka ata që përfitojnë dhe ata që humbasin. Është një zero-sum game, dikush fiton dhe dikush humbet, shuma në fund është zero. Qeveria e Republikës së Shqipërisë është një nga fituesit e kësaj krize, buxheti i shtetit, e keni thënë vetë. Shifrat që jepni janë në rritje të dukshme dhe për këdo që di "abc"-në e financave është rezultat i rritjes së çmimeve.

Tani, këtu fillon dallimi i atyre që kanë përgjegjësi dhe atyre, të cilët nuk kanë një të tillë, apo për të qenë më të saktë, për çështjet që keni përgjegjësi dhe për çështjet që nuk keni përgjegjësi. Me kë jeni ju, me fituesit apo me humbësit nga kjo krizë?! Më lejoni t'ju them disa shembuj: "...me shqetësimin e madh - thotë zëvendëskancelari i Gjermanisë - për kohezionin social, për paqen sociale, për ndjenjën dominante që duhet të ketë shoqëria, që jeton në kushtet e drejtësisë dhe të barazisë", a i keni ju këto kritere në politikbërjen tuaj? Çfarë bëri

politika gjermane? Politika gjermane reduktoi çmimin e benzinës me 30 cent dhe atë të diesel-it me 14 cent.

Sot qytetari gjerman që i ka të ardhurat për frymë 49 mijë dollarë e blen benzinën dhe naftën më lirë sesa qytetari shqiptar, i cili i ka 5200, nëse i ka edhe ato, dollarë të ardhurat për frymë ndaj GDP-së. Pra, qytetari gjerman, që i korrespondojnë 9 herë më shumë të ardhura, e paguan më lirë benzinën dhe diesel-in sesa qytetari më i varfër i kontinentin europian, që është ai i vendit tonë. Nuk e di nëse Rama, duke e gjurmuar nga mbrapa Presidentin e nderuar Biden korridoreve të Samitit të Madridit, arriti t'i bëjë ndonjë pyetje se përse Kongresi i propozon atij të heqë taksën federale nga karburantet?

Pra, Presidenti amerikan mendon për qytetarin e vet, që i ka të ardhurat për frymë 63 mijë dollarë, duke i propozuar Kongresit pezullimin e taksës federale, ndërsa në deklaratën e stoikut, timonierit tonë, gjeniut të financave, me përmbaueset e tij, që qëndrojnë për të stolisur podiumet ministore, tha: "Taksat e naftës nuk do të hiqen dhe për këtë nuk ka protestë me drita Iphon-i dhe bllokim rrugësh me goma X5-ash. Qytetarët shqiptarë janë me X5 dhe telefona Iphon-i, siç nuk janë qytetarët gjermanë apo qytetarët amerikanë". A e shikoni mjerimin tuaj politik dhe retorik, zonja të nderuara? Ju sillni sot një akt normativ, në të cilin nuk përpiqeni aspak të fshihni karakterin tuaj klasor me politikën tuaj.

Ju pozicionoheni me oligarkët. Juve nuk ju intereson çmimi i qumështit, nuk ju intereson çmimi i miellit, nuk ju intereson çmimi i karburantit, juve ju intereson çmimi i çimentos dhe i hekurit. Pse? Sepse ju jeni qeveria e klientëve tuaj. Ju jeni qeveria e oligarkëve. Ju nuk ndjeni përgjegjësi ndaj qytetarëve, sepse qytetarët nuk ju kanë zgjedhur asnjëherë. Ju ua keni rrëmbyer votën. Ju i keni mjeruar, i keni bërë të varur nga politika juaj e ditës për bukën, për kafshatën e gojës. E theksoj sërish: nuk janë oligarkët klientët tuaj, por qeveria juaj është kliente e tyre. Ju jeni të varur dhe të ndërvarur nga 1 mijë fije prej tyre dhe vini sot për të konkretizuar me ligjvënien në parlament interesat e tyre.

Zonja dhe zotërinj,

Kjo është e paprecedentë. Herën e kaluar përmenda masat e marra nga qeveri të ndryshme për të tatuar me tatim të jashtëzakonshëm fitimet e jashtëzakonshme të disa kompanive. Juve nuk ju interesoi dhe as nuk e diskutuat e jo më të vendosnit masa të tilla. Juve ju intereson vetëm korrupsioni, të cilin e keni ngritur në system dhe me të cilin ushqeheni dhe ushqeni. Kryeministri juaj tha: “Kemi probleme për tenderimin” dhe në Konferencën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit propozoi që në Republikën e Shqipërisë tenderimi i veprave publike t’i ngarkohet një kompanie të huaj apo një organizmi ndërkombëtar.

Pra, e pranoni vetë që korrupsioni në atë sistem është deri në palcë, ndërsa sot vini për të miratuar një akt normativ kryekëput në interes të klientëve korruptivë të korrupsionit dhe ju jeni përfitues të drejtpërdrejtë të saj. Duke përfunduar do t’ju kujtoj një thënie të një tragjediani të Athinës së viteve 400 para Lindjes së Krishtit, Agathonit, i cili thoshte: “Qeveritari duhet të kenë tri gjëra parasysh: të qeverisë qytetarët, t’i qeverisë me ligje dhe qeveria nuk zgjat përjetë”. Ju nuk i keni mirë parasysh këto gjëra, nuk i bëni mirë llogaritë. Në një kohë që vini me akte të tilla normative, pa u përpjekur të fshiheni nga qytetarët e këtij vendi, jo më nga ne, mediet apo shoqëria civile, kini parasysh që do të vijë momenti kur do të doni të fshiheni, por nuk do të gjeni vend se ku. Faleminderit!